




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	01-2602/14
Data Datum Date	11-07-2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	07.07.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Arianit JAKUPI, UD Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuari z. Jakupi,

Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK-03-2371/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia kundër Korrupsionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprore, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Prandaj, bazuar në kërkesën tuaj, se a paraqet konflikt interesi ushtrimi i aktivitetit privat gjatë ushtrimit të funksionit publik si UD Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kemi nxjerr këtë:

OPINION

Ekziston konflikt i mundshëm i interesit nëse gjatë ushtrimit të funksionit tuaj publik ushtroni funksion menaxhues në çfarëdo biznesi privat.

Arsyetim

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (në tekstin e mëtejshëm L.P.K.I.) pozita juaj si UD Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Në bazë të nenit 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të parandalojnë dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Prandaj, për pyetjen tuaj se a ekziston konflikt interesi lidhur me aktivitetin privat të cilin, siç keni deklaruar, e keni poseduar para se ta ushtroni funksionin publik, L.P.K.I., ka paraparë disa kufizime.

Kufizimet e tilla kanë të bëjnë me ndalesa për funksione tjera krahas ushtrimit të funksionit publik.

Në kohën kur një zyrtar publik ushtron funksione publike, ai nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike, si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit (neni 16, paragrafi 1).

Në bazë të kësaj dispozite, të qenurit pronar i biznesit në fjalë nuk është e ndaluar, ndërsa të qenurit person i autorizuar në këtë biznes ndalohet pikërisht me nenin e lartpërmendur.

Si rezultat i kësaj duhet të autorizohet një person i besueshëm, siç parashihet me nenin 14 të L.P.K.I. Personi i besueshëm nuk mund të jetë i afërt me zyrtarin e lartë (Neni 3, pika 1.4 dhe 1.5).

Andaj, konform asaj që u tha më lartë, iu rekomandojmë që të ndërmerrni të gjitha masat konform këtij opinioni, që të parandaloni konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt!